


# Statistikat e Blegtorisë 2019

**Tiranë, më 19 Qershor 2020:** Numri i gjedhëve në vitin 2019 është 415.609 krerë, duke shënuar rënie me 11,07 %, në krahasim me vitin 2018. Përqendrimi më i madh i numrit të krerëve është në qarkun e Fierit me 16,33 % dhe në qarkun e Elbasanit me 10,38 % ndaj numrit gjithsej të gjedhëve.

Fig. 1 Struktura e gjedhit sipas qarqeve



Në vitin 2019, numri i të leshtave është 1,75 milionë krerë, duke shënuar rënie me 5,66 %, krahasuar me vitin 2018. Kategoria kryesore e të leshtave përbëhet nga delet e qumështit me 71,51 % ndaj totalit të tufës. Përqendrimi më i madh i numrit të krerëve është në qarkun e Vlorës me 20,29 % dhe në qarkun e Fierit me 15,27 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.

Numri i të dhirtave në vitin 2019 është 862.865 krerë, duke pësuar rënie vjetore me 5,92 %, në krahasim me vitin 2018. Kategoria kryesore përfaqësohet nga dhitë e qumështit, me 77,75 % ndaj totalit të tufës. Përqendrimi më i madh i numrit të krerëve është në qarkun e Vlorës me 16,63 % dhe në qarkun e Gjirokastrës me 14,12 % ndaj numrit gjithsej të krerëve.


Në vitin 2019, numri i krerëve të derrave është 183.847 krerë, duke shënuar rënie vjetore me 0,16 %, krahasuar me vitin 2018. Përqendrimi më madh i numrit të derrave është në Lezhë me 35,86 % dhe Shkodër me 27,08 % ndaj numrit gjithsej krerëve.

**Tab. 1 Numri i krerëve të blegtorisë (mijë krerë)**

Emërtimi	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Gjedhë</b>	<b>504</b>	<b>492</b>	<b>475</b>	<b>467</b>	<b>416</b>
Lopë	357	355	349	343	316
<b>Të leshta</b>	<b>1.918</b>	<b>1.972</b>	<b>1.925</b>	<b>1.864</b>	<b>1.758</b>
- Dele	1.417	1.428	1.407	1.366	1.257
<b>Të dhirta</b>	<b>932</b>	<b>941</b>	<b>933</b>	<b>917</b>	<b>863</b>
- Dhi	700	716	717	699	671
<b>Derra</b>	<b>171</b>	<b>181</b>	<b>180</b>	<b>184</b>	<b>184</b>
- Dosa	11	13	12	12	14
<b>Njëthundrakë</b>	<b>91</b>	<b>94</b>	<b>89</b>	<b>88</b>	<b>87</b>
- Kuaj	31	34	32	32	32
<b>Shpendë</b>	<b>8.558</b>	<b>8.326</b>	<b>7.835</b>	<b>8.362</b>	<b>8.179</b>
-Pula	5.323	4.790	4.820	4.963	5.004
<b>Bletë/koshere</b>	<b>271</b>	<b>303</b>	<b>290</b>	<b>285</b>	<b>288</b>

Prodhimi i qumështit në vitin 2019 është 1,11 milionë tonë, duke shënuar një rënie me 2,81 %, në krahasim me vitin 2018. Struktura e prodhimit të qumështit, referuar vitit 2019 është: qumësht lope 85,11 %, qumësht dele 7,34 % dhe qumësht dhie me 7,55 %.

**Fig. 2 Prodhimet blegtorale**



Në 2019, prodhimi i qumështit nga lopët është 946.561 tonë, ose 2,77 % më pak, krahasuar me 2018. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit në nivel vendi në 2019 është 2.981 kg për krerë duke u rritur me 2,23 %, krahasuar me 2018.

Prodhimi qumështit nga delet, për vitin 2019, ka pësuar rënie me 3,67 %, krahasuar me vitin 2018. Rendimenti mesatar vjetor, në nivel vendi i qumështit të deles është 63 kg për krerë duke shënuar rritje me 2,12 %, krahasuar me vitin 2018.

Prodhimi qumështit nga dhitë në 2019 është 2,41 % më i ulët se një vit më parë. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit nga dhitë në nivel vendi është rreth 127 kg për krerë duke u rritur me 3,21 %, krahasuar me vitin 2018.

Prodhimi i mishit peshë e gjallë është 157 mijë tonë, duke shënuar rënie me 2,77 %, në krahasim me vitin 2018.

Prodhimi i vezëve për vitin 2019 është 865 milionë kokrra, duke shënuar rritje me 4,47 %, në krahasim me vitin 2018.

**Tab. 2 Prodhimet blegtorale (mijë tonë)**

Emërtimi	2015	2016	2017	2018	2019
Qumësht	1.131	1.145	1.156	1.144	1.112
Mish peshë e gjallë	158	160	161	161	157
Vezë/milionë kokrra	830	830	811	828	865

# Metodologjia

Statistikat e blegtorisë për vitin 2019 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave bujqësore dhe blegtorale mbështeten në Programin e Statistikave Zyrtare 2017 - 2021, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE-së.

Informacioni mbledhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermerë, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Të dhënat blegtorale grumbullohen për numrin e kafshëve që mbarështojnë fermerët si dhe prodhimet blegtorale. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë të dhëna për të krahasuar dhe me të dhënat e shërbimit veterinar i cili kryen matrikullimin dhe vaksinimin e kafshëve (proçesi është në vazhdimësi). Shërbimi veterinar kryen në momentin e vaksinimit inventarin e kafshëve në nivel komune. Specialistët e ekstensionit kanë marrëdhënie dhe me veterinerët privatë. Këta veterinerë kryejnë shërbime të ndryshme në mënyre private pranë fermerëve (si kontroll nga sëmundjet, ngordhje të kafshëve apo lindje, therje, vaksinime etj). Në fund specialistët e ekstensionit krahasojnë të dhënat nga të tre burimet. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë gjithashtu të dhëna për prodhimet bujqësore dhe blegtorale nga fermerët. Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel komune. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit blegtoral bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Ministria e Bujqësisë përdor tre burime informacioni për grumbullimin e të dhënave:

1. Ekspertët e ekstensionit që janë pjesë e strukturave të Drejtorive të Bujqësisë
2. Shërbimin veterinar
3. Veterinerët privat

## Përkufizime

**Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEK)** - është njësi e vetme, teknike ekonomike, e përcaktuar në një drejtim unik, nga terreni dhe pse në parcela jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral që drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore – blegtorale.

Njësi ekonomike bujqësore konsiderohen edhe njësitë ekonomike me drejtim të plotë blegtoral, në të cilat arrihet mbarështimi i kafshëve pa pasur në administrim tokë bujqësore, pra ku toka nuk figuron si element përbërës i njësisë.

**Blegtoria dhe shpendët** mbulojnë të gjitha kafshët pavarësisht nga mosha e tyre vendndodhja ose qëllimi i tyre për mbarështim. Kafshët mund të jenë prezent në Njësinë Ekonomike Bujqësore, ose jashtë fermave bujqësore në kullotë.

#### **Klasifikimi**

Klasifikimi i kafshëve bëhet sipas llojeve (gjedhë, të leshta, të dhirta, derra, kuaj), sipas moshës, seksit dhe destinacionit ekonomik.

Shpendët janë të grupuar në një grup të vetëm dhe përfshihen pulat, pulat afrikane, gjela deti, pata, rosa, etj.

#### **Prodhim mishi peshë e gjallë**

Vlerësimi për prodhimin e mishit peshë e gjallë kryhet për çdo lloj kafshe. Llogaritja e prodhimit të mishit peshë e gjallë bazohet në përlogaritjet e bëra nga lëvizja e blegtorisë, pra në numrin e krerëve të skartuar për gjedhë, të leshta, të dhirta, derra dhe shpendë, sipas kategorive të therjes, dhe në peshën e gjallë mesatare për krerë të therur sipas llojeve dhe kategorive të therjes.

#### **Rregullat kryesore për grumbullimin e të dhënave**

Numri i krerëve të blegtorisë i referohet datës 1 dhjetor 2019.

Fermeri pyetet për të gjitha llojet e kafshëve që ai zotëron.

Informacioni grumbullohet vetëm për numrin e krerëve që ka në zotërim njësi ekonomike bujqësore

Të gjitha kafshët e blera nga ekonomi të tjera gjatë vitit numërohen.

Të gjitha kafshët e shitura ekonomive të tjera gjatë vitit nuk numërohen.

Lindjet e blegtorisë janë të lindurit gjatë 12 muajve të fundit. Nuk përfshihet blegtoria lindur e ngordhur.

Humbjet e kafshëve gjatë vitit, ngordhje, ngrënie nga egërsirat, apo nga shkaqe natyrore nuk numërohen.